



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1367 Prot.

Fier, më 24.08 . 2026

Lënda: Njoftim për dorëzim dokumentacioni për punësim nga jashtë portalit "Mësues për Shqipërinë" për vitin shkollor 2026-2027.

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimit nr. 19, datë 29.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, kreu IV pika 13/1, ju njoftojmë si mëposhtë:

Kandidatët e interesuar për punësim **të cilët nuk janë pjesë e portalit "Mësues për Shqipërinë"**, të paraqesin në rrugë postare në ZVAP Fier dokumentacionin për punësim nga jashtë si mëposhtë :

1. Kartë identiteti
2. Kërkesë për punësim nga jashtë
3. Diplomë dhe listë notash
4. Kopje e licenses së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit (nëse ka)
5. Dëshmi kualifikimi (nëse ka)
6. Dëshmi të gjuhëve të huaja (nëse ka)
7. Libreze pune (nëse ka)
8. Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera (nëse ka)
9. Certifikatën e gjendje gjyqësore (dëshmi penaliteti)
10. Vërtetim nga prokuroria, që kandidati nuk është në ndjekje penale për kryerjen e një vepre penale
11. Vërtetim nga gjykata, që kandidati nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale
12. Vërtetim mjeko-ligjor

Dokumentacioni i sipërcituar të përcillet i njëhësuar me origjinalin.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të sipërcituara është data **04.09.2026**

Sqarim: Punësimi i kandidatëve të interesuar lidhur me këtë procedurë do të bëhet vetëm në rastet kur nuk ka kandidatë në portalin "Mësues për Shqipërinë" në profilet e kërkuara dhe në profilet e përafërta dhe as kandidatë në nivel DRAP-i.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR

Miglena Softon

Adresa: Rr.Leon Rei, Fier

e-mail: ZVAFier@arsimi.gov.al

